L I G J
Nr.9186, datë 12.2.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR PROJEKTIN "FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË SHQIPËRINË E MESME – KOMPONENTI I LUSHNJËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme – komponenti i Lushnjës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4163, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR (VITI 2000)
"FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË SHQIPËRINË E MESME, KOMPONENTI I LUSHNJËS"

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe pët t'i thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 23 qershor 2000;

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua me vleftë prej gjithsej deri në 4 601 626 93 euro (katër milionë e gjashtëqind e një mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë 93/100 euro) për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme, komponenti i Lushnjës", kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të

Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatimin kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për huanë nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 20 tetor 2003 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe atë gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.